



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1647/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NLB Banka Sh.a, me nr. Biznesi 70053484, me seli ne Prishtinë rr.”Ukshin Hoti” nr.124, ndaj debitorëve 1. Avokat V.H. B.I, me nr. Biznesi 71136159 , me seli ne Prishtinë si dhe 2. V.H. me nr. Personal ..., me adresë ne Prishtinë rr.” Hamdi Mramori”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.1535/22 dt.27.09.2023, me datën 20.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e debitorëve 1. Avokat V.H. B.I, me nr. Biznesi 71136159, me seli ne Prishtinë si dhe 2. V.H. me nr. Personal ..., me adresë ne Prishtinë rr.”Hamdi Mramori”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.1535/22 dt.27.09.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1535/22 dt.27.09.2023, ne pjesën e I te dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorëve 1. Avokat V.H. B.I, me nr. Biznesi 71136159 , me seli ne Prishtinë si dhe 2. V.H. me nr. Personal ..., me adresë ne Prishtinë rr. ”Hamdi Mramori” dhe ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.469/2019 dt.29.10.2019, te lejuar nga Përmbaruesja Private Myjsere Mujku, sa i përket detyrimit prej 170.54 euro me kamatë ligjore prej 24%. Ne pjesën II te dispozitivit te aktvendimit ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.469/2019 dt.29.10.2019 te lejuar nga Përmbaruesja Private Myjsere Mujku, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë, për pjesën e detyrimit prej 15,812.73 euro.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës kontestimore, aplikimit te gabuar te se drejtës materiale dhe vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike, me propozim qe te aprovohet ankesa e debitorit dhe urdhri përmbarimor te anulohet.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorëve është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NLB Banka sh.a, me nr. Biznesi 70053484 , me seli ne Prishtinë rr.”Ukshin Hoti” nr.124, me datën 29.10.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve 1. Avokat V.H. B.I, me nr. Biznesi 71136159 , me seli ne Prishtinë si dhe 2. V.H. me nr. Personal ..., me adresë ne Prishtinë rr.” Hamdi Mramori”, në bazë të dokumentit përmbartimor Marrëveshje mbi Pengun ne Llogaritë Bankare nr. K118/1513 dt.11.04.2018, Visa Credit Kartelë Revolving dt.29.07.2016, Kontratë për Kredi Biznesi nr. K0118/1513 dt.11.04.2018, Konfirmim Regjistrimit R-20180413-10 nga data 13.04.2018 deri me 11.04.2023. Përmbartuesja Private Myjsere Mujku nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.469/19 dt.29.10.2019, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit t’i paguaj shumën e detyrimit qe rrjedh nga marrëveshjet e sipër cekura, në vlerë totale prej 15,983.27 €, me kamatëvonesë ditore prej 0.08% si dhe shumën prej 170.54 euro ne bazë te kontratës Visa Credit Kartelë Revolving.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori, me datën 18.11.2019, ka paraqitur prapësim, me pretendimin se bazuar ne parimin Pacta Sunt Servanda dhe Rebus Sic Standibus, neni 116 par.1 e LMD, palët kanë te drejtë te kërkojnë zgjidhjen e kontratës ne rast se nuk mund ti përmbushin detyrimet e po ashtu edhe ajo se palët me rastin e lidhjes se kontratës nuk kanë mundur ti parashikojnë rrethanat te cilat lindin pa fajin e tyre, atëherë mund te kërkojnë te zgjidhet ose te ndryshohet kontrata, dhe debitori si palë e goditur kërkon ndryshim, shton se ka informuar kreditorin duke pasur parasysh nenin 117 te LMD, andaj kundër propozimit për përmbartim bazuar ne nenin 67 te LPP paraqet këtë prapësim, me propozim qe gjykata ta aprovoj prapësimin ndërsa propozimin e kreditorit ta anuloj dhe kreditorin te urdhërohet te paguan te gjitha shpenzimet.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit me datën 21.11.2019, ka ushtruar kreditori, me arsyetimin se pretendimi i debitorit është i pabazuar dhe prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur ne asnjë fakt domethënës, propozon qe gjykata ta refuzojnë prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta vërtetoj ashtu qe te vazhdohet me procedurën përmbartimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1535/22 dt.27.09.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi pjesërisht urdhrin përmbartimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata pas kronologjisë se procedurës ne këtë çështje gjene se dokumenti mbi bazën e te cilit është lejuar përmbartimi dhe atë kontrata mbi pengun e llogarive bankare është e regjistruar

ne regjistrat publik te pengut, e njëjta përmban te gjitha elementet e përcaktuara me nenin 27 par.1 te LPP, i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par.1.7 te LPP dhe si e tille është i përshtatshëm për përmbarrim. Po ashtu gjykata konstaton se urdhri përmbarrimor është lejuar edhe ne bazë te dokumentit Visa Credit Kartelë Revolving dt.29.07.2016 por qe dokumenti ne fjalë nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarrimit sepse neni 22 i LPP ne mënyrë taksative numëron titujt përmbarrimor mbi bazën e te cilave mund te lejohet përmbarrimi. Ky dokument nuk është i siguruar as me Marrëveshjen e Pengut mbi llogaritë Bankare K0118/1513 dt.11.04.2018 dhe as me ndonjë kontratë tjetër te veçantë te Pengut, ashtu qe mbi këtë bazë gjykata vendosi ta aprovoj pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj urdhrin për lejimin përmbarrimit për shumen prej 170.54 euro. Gjykata vendosi si ne piken e II te dispozitivit duke lënë ne fuqi urdhrin përmbarrimor sa i përket detyrimit prej 15,812.73 €, shumë kjo e siguruar me Marrëveshjen e Pengut mbi Llogaritë Bankare pasi ne ketë pjesë te detyrimit debitori nuk e ka bërë te besueshëm prapësimin me prova konkrete si dhe nuk i ka përmbushur asnjë nga kërkesat ligjore te përcaktuara me nenin 71 te LPP lidhur me nenin 69 par.4 te LPP, andaj edhe ka vendosur si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj vendimin e gjykatës se shkalles se parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson faktin se baza juridike për caktimin e përmbarrimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarrimin sipas dokumentit të përmbarrimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, dhe në prapësimin e debitorit nuk janë paraqitur asnjë nga shkaqet të cilat janë parapara në nenin 71 të LPP-së, që do të pengonin përmbarrimin e lejuar.

Dhoma e Shkalles se Dytë, bazuar ne shkresat e lendes vlerëson se gjykata e shkalles se parë drejt ka vlerësuar se dokumentet mbi bazën e te cilave është mbështetur propozimi për përmbarrim, paraqesin titull ekzekutiv dhe se Marrëveshja mbi Pengun ne Llogarit Bankare K0118/1513 dt.11.04.2018 është dokument përmbarrimor dhe e rregulluar me dispozita ligjore dhe atë sipas nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, i cili shprehimisht përcakton: *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas nën-paragrafit 1.7, shtohet nën-paragrafi ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut*. Vlerësuar ne këto arsye edhe gjykata e shkalles e dytë gjënë se kjo marrëveshje është e regjistruar ne regjistrat zyrtar te pengut gjë qe tregon Konfirmimi i regjistrimit R-20180413-10 datë 13.04.2018, lëshuar nga Zyra për Regjistrimin e Pengut ne Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, po ashtu objekti i pengut është i regjistruar dhe vazhduar dhe se vlefshmëria e këtij

regjistrimi është deri me datën 11.04.2023. Kjo gjykatë analizoi edhe pretendimin ankimor te palës debitore sa i përket origjinalitetit te dokumentit te konfirmimit te regjistrimit, por vlerësoi se ky pretendim nuk është relevant për një vendosje ndryshe sepse kreditori i ka bashkangjitur propozimit për përmbarrim dokumentin Marrëveshja mbi Pengun ne Llogaritë Bankare ne kopje te vërtetuar tek noteri Isak H.Ademi me seli ne Prishtinë, ashtu siç parasheh neni 36 par.1 i LPP i cili përcakton qe “Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri”, ashtu qe gjykata e shkalles dytë vlerësoj se pretendimet e debitorëve janë te pabazuara dhe te natyrës deklarative dhe si te tilla i refuzoi ndërsa aktvendimin shkalles se parë e vërtetoj.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore konofrm parimit te rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II.nr.1647/23, datë 20.02.2024

Gjyqtari
Ramush Bardiqi